



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 34-të e (jashtëzakonshme) të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 16. 07. 2020, në sallën e kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Ramadush Tasholli, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Naim Stullca, anëtar
9. Majlinda Sylejmani, anëtare
10. Fatime Krasniqi, anëtare
11. Arif Miftari, anëtar
12. Xhyzide Rustemi, anëtare
13. Lulzim Rustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi-Hasani
18. Shkelzen Bislimi, anëtar
19. Afrim Miftari, anëtar
20. Hajdin Bytyqi, anëtar
21. Safete Amerllahu, anëtare
22. Bashkim Budakova, anëtar
23. Ukë Kryeziu, anëtar
24. Ganimete Qeriqi, anëtare
25. Egzona Fazliu, anëtare
26. Arben Salihu, anëtar
27. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës
3. Lulzim Qerimi, nënkryetar i Komunës për komunitete

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Naser Bytyqi**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve nga gjithsej 31 anëtarë të Kuvendit, hapi mbledhjen e 34 të jashtëzakonshme të ftuar nga 11 anëtarët e Kuvendit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. Miratimi i deklaratës lidhur me veprimin e Zyrës së Prokurorit të specializuar për të publikuar njoftimin për një aktakuzë të pa konfirmuar nga Gjyqtari i procedurës paraprake.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, pyeti se a ka dikush vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës.

Pasi që vërejtje nuk pat Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës dhe pas votimit konstatoi se me të gjitha votat prezent u aprovua rendi i ditës.

Në vazhdim Kryesuesi i dha fjalën propozuesit i cili e lexoi deklaratën me të cilën kundërshtohet veprimi i prokurorisë speciale dhe publikimi i akuzës së pakonfirmuar nga gjyqtari për dy udhëheqësit e UÇK-së, z.Hashim Thaqi dhe z.Kadri Veseli.Pjesë përbërëse e diskutimit është edhe leximi i deklaratës së propozuar.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin,dhe fjalën i dha kryetarit të komunës z.Imri Ahmeti.

Imri Ahmeti,përshendetje për të pranishmit,është fakt se vendi po ballafaqohet me sfida të ndryshme dhe iu uroj shërim sa më të shpejtë të prekurve nga virusi dhe ngushëlloi familjet për humbjen e më të dashurve në betejë me këtë virus.Është fakt se publikimi i akuzave ndaj vlerave të luftës së UÇK -së është sfidë për të gjithë ne.Ne jemi unik në mbrojtje të vlerave të luftës por një gjë duhet ta dini se deklaratat e kopjuara nga të tjerët nuk është mirë të prezantohen, sepse nëse e lexoni me kujdes është identike me atë të Skenderajit.Është dashur që propozuesi apo individ të ulen së bashku dhe të hartojnë deklaratën me të cilën vërtetë do të mburremi si kuvend sepse në këtë formë po denigrohet intelijenca e kuvendarëve.

Hyra Bytyqi,përshëndeti të pranishmit dhe shprehi qëndrimin e LDK-së e cila është për një deklaratë në të cilën shprehë besimin në luftën e drejtë dhe të pastër të UÇK -së kundër një diktature dhe regjimit gjenocidal të Sërbisë ndaj Kosovës,por jo të miratojmë deklarata plagjiaturë të kopjuara nga të tjerët.Ne kemi hartuar një deklaratë të cilën do ta lexoj dhe kërkoj aprovimin që bashkarisht ta aprovojmë këtë deklaratë.Pjesë përbërëse e proceverbalit është deklarata të cilën e lexoi.

Shkëlzen Bislimi,përshëndetje për të pranishmit,siq e ka thënë edhe kryeministri Kurti,sa i përket gjykatës speciale dhe vetë ngritja e kësaj gjykate është padrejtësi ndaj shtetit të Kosovës,por fajtorë janë ata të cilët e aprovuan atë, ne nuk përkrahim deklaratë ku përmenden emrat e përvetshëm,por do të përkrahim një deklaratë që përkrah luftën e drejtë të UÇK -së dhe mendoj se deklarata që e lexoi Hyra është më e drejtë.

Arben Salihu,përshëndetje për të pranishmit,unë propozoj që të ulemi dhe ta ndryshojmë nëse ka nevojë deklaratën,nuk është me rëndësi se kush akuzohet por mendoj se UÇK -ja është mbi të gjithë ne dhe duhet të jemi unik në mbrojtje të luftës së

UÇK -së. Deklaratën e Hyrës ta shndërrojmë në deklaratë të përbashkët të kuvendit komunalë.

Ramiz Qeriqi,përsëendetje për të pranishmit,mua më së paku më takon që të diskutoj rreth kësaj,është bërë gabim që nuk jemi ulur së bashku për të hartuar deklaratën por duhet të kemi parasysh që është ftuar presidenti i vendit dhe atë pikërisht kur është dashur të jetë në udhëtim për bisedime në Vashington.

Afrim Miftari,përsëendetje për të pranishmit dhe theksoj se është mirë që ekziston vullneti i përbashkët që kuvendi të miratoi një deklaratë dhe është mirë që të harmonizohet dhe nëse është nevoja shefat e grupeve parlamentare ta harmonizojnë dhe pastaj ta marrë përkrahjen në kuvend.

Lulzim Rrustemi,nuk duhet të kemi paragjykime sepse pikërisht është dhe duhet të jetë deklaratë unike në tërë vendin dhe nuk është plagjiaturë,mendoj se duhet të jemi së bashku dhe unik për këtë qështje.Ne kemi dëshiruar që deklarata të jetë unike por nëse ju mendoni atëherë le të ulemi dhe t'i harmonizojmë këto propozime.

Imri Ahmeti,e para e punës nuk është marre me pranë që është plagjiaturë,por me provu që një deklaratë të tjetërkujt ta prezentoni në kuvend.

Ramiz Qeriqi,dola në foltore që të ju lusë që ta aprovojme deklaratën,qëllimi është i mirë dhe se duhet ta bëjmë këtë punë.

Manush Shamolli,përsëendetje për të pranishmit,unë në fakt po befasohem me akuzat të ndërsjellta mendojë se kur është në pyetje lufta e UÇK -së duhet të jemi unik dhe pak ka rëndësi se cila deklaratë duhet të aprovohet,por po ju them se kërkohet nga ne të aprovojme një deklaratë.

Lulzim Rrustemi,unë kam problem me i ndryshu bindjet dhe paragjykimet e kryetarit por po e theksoj edhe një herë që kjo deklaratë është menduar që të jetë unike në tërë vendin dhe të jetë përkrahëse e luftës së drejtë të UÇK-se dhe në përkrahje të udhëheqësve të tjerë.

Naim Krasniqi,përsëendetje për të pranishmit,nuk deshta me dale fare në foltore por më shtyn diskutuesit e më hershëm dhe më vjen mirë që qëllimi është i përbashkët në përkrahje të UÇK -së dhe luftës sonë,ndërsa se cila deklaratë do të votohet nuk ka rëndësi por ne duhet të ecim përpara.

Bashkim Budakova,përsëendetje për të pranishmit,më vjen mirë dhe mendoj se të gjithë jemi në përkrahje të luftës së UÇK-së dhe luftës së popullit shqiptarë për liri. UÇK -ja ishte e popullit e jo një subjekti politik.

Imri Ahmeti,ideja është e përbashkët dhe sublime.

Ganimete Qeriqi,përsëendetje për të pranishmit ,i ndëgjova me vëmendje të gjitha diskutimet dhe mendoj se janë me vend,por mendoj se me rëndësi është që të kemi një deklaratë me të cilën mbrohen vlerat e UÇK -së dhe luftës tonë për liri.

Lulzim Rrustemi,mendoj se nuk duhet të diskutojmë më shumë dhe theksoj se cila do deklaratë që të shkojë nuk prish fare punë dhe nëse mendoni që të shkojë deklarata e Hyres atëherë le të jetë ashtu,dhe ne tërhiqemi nga propozimi i deklaratës tone.

Kryesuesi vuri në votim deklaratën e propozuar nga Hyra Bytyqi dhe pas votimit me vota unanime të anëtarëve të kuvendit komunalë aprovoi;

DEKLARATË

1. Ne anëtarët e Kuvendit të Komunës së Lipjanit si përfaqësues të qytetarëve të Komunës tonë shprehim papajtueshmërinë dhe shqetësimin tonë për qasjen e Zyrës së Prokurorisë Speciale në raport me prijësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

2. Ne rikonfirmojmë besimin tonë në luftën e drejtë dhe pastërtinë e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe popullit të saj kundër regjimit gjenocidal serb.
3. Ne jemi të bindur se vlera e sakrificës së Ushtisë Çlirimtare të Kosovës, popullit shqipëtar me përkrahjen e NATO-s, SHBA-ve dhe aleatëve të saj, janë vetë ekzistencë jonë dhe jemi të bindur që edhe kësaj here do të dëshmohet pastërtia e luftës çlirimtare për liri e pavarësi.
4. Ritheksojmë njëzëri mbështetjen dhe solidarizimin tonë të përhershëm ndaj udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe gjithë pjesëtarëve të UÇK-së dhe gjykojmë çdo tendencë të kriminalizimit dhe abuzimit me të kaluarën e lavdishme të popullit tonë
5. Zotohemi se do të jemi të përkushtuar që vlerat e pastërta të luftës çlirimtare të popullit të Kosovës do t'i ruajmë dhe avansojmë si vlera sublime dhe të patjetërsueshme të kombit tonë.
6. Ftojme të gjithë përfaqësuesit e të gjitha institucioneve shtetërore, nga të gjitha partitë politike, për unitet dhe veprime të përbashkëta në dobi të mbrojtjes së vlerave sublime të luftës çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Shtesë-Deklarata

Pasi çështje të tjera nuk pati mblledhja përfundoi në ora 11,²⁰

Ekstraktin e hartoi
Naser Bytyqi

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi